

MENDIM PARALEL

Unë gjyqtare Blerona Hasa, parashtoj mendimin tim në çështjen administrative Nr.18 Regj Dt.11.05.2023, me:

PADITËS: Subjekti Zgjedhor Partia e Lirisë.

IPADITUR: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

PERSON I INTERESUAR: Subjekti Zgjedhor Partia Drejtësi Integrim dhe Unitet.

OBJEKTI: Ndryshimin e Vendimit nr. 90, datë 10.05.2023 të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve (KAS) në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, duke vendosur: *Caktimin e Partisë së Lirisë si parti politike që i lind e drejta e propozimit për anëtarin e katërt të grupeve të numërimit të votave, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023.*

BAZA LIGJORE: Neni 6, paragrafi 1, i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, Nenet 9, 45, 46 e vijues të Kushtetutës së Shqipërisë, Nenet 63, 64, 65, 98, 139, 145 e vijues të Kodit Zgjedhor.

Kolegji Zgjedhor Gjyqësor, në trup gjykues të përbërë nga gjyqtarët Edlira Petri kryesuese (relatore), me anëtarë Sokol Ibi, Alma Kolgjoka, Emona Muçi dhe Blerona Hasa, në përfundim të shqyrtimit të çështjes, vendosi unanimisht, rrëzimin e kërkespadsisë.

Unë gjyqtare Blerona Hasa, e bazoj disponimin tim mbi rrëzimin e padsisë, në shkaqe të ndryshme nga shumica, parashtruar në vijim.

Sikurse evidentohet edhe në vendimin e shumicës, çështja që shtrohet për zgjidhje në këtë rast, lidhet me interpretimin dhe zbatimin e normave që rregullojnë ngritjen e Grupeve të Numërimit të Votave, në një proces zgjedhor.

Në këtë kontekst vlerësoj se lipset vërejtur paraprakisht se, Kodi Zgjedhor parashikon si **rregullin e përgjithshëm**, ashtu edhe **përgjithshëm nga ky rregull**, lidhur me:

- Ngritjen e Grupeve të Numërimit të Votave (GNV);
- Procedurën për përcaktimin e partive që propozojnë anëtarë të GNV-ve.

Konkretisht, nëpërmjet Neneve 95 dhe 96, parashikohet rregulli i përgjithshëm, sipas të cilit:

Neni 95

“... 2. Grupet e numërimit të votave përbëhen nga katër anëtarë, ku në çdo rast një anëtar emërohet pas propozimit të partisë politike, së cilës i përket kryetari i KZAZ-së, një anëtar pas propozimit të partisë që i përket nënkryetari, ndërsa anëtari i tretë propozohet nga partitë e shumicës qeverisëse dhe anëtari i katërt emërohet pas propozimit të partive të opozitës që kanë të drejtë të propozojnë anëtarë të GNV-ve për ZAZ-të respektive, sipas procedurës së parashikuar në nenin 96 të këtij Kodi...””.

“1. Partitë politike që kanë të drejtë të propozojnë anëtarin e tretë dhe të katërt të GNV-ve, përveç partive që propozojnë kryetarin dhe nënkryetarin e KZAZ-së, përcaktohen pas hedhjes së shortit në KQZ ndërmjet listës së partive politike të shumicës parlamentare dhe listës së partive të opozitës parlamentare të regjistruara në zgjedhje dhe që kanë fituar jo më pak se dy mandate në zgjedhjet pararendëse për Kuvendin e Shqipërisë. Në çdo rast, pas hedhjes së shortit për çdo ZAZ, të drejtën e propozimit për dy anëtarë të Grupit të Numërimit të Votave e ka një parti e shumicës parlamentare dhe një parti e opozitës parlamentare ...”.

Përjashtimi nga rregulli i përgjithshëm i Neneve 95 dhe 96, rezulton të jetë miratuar me Ligjin Nr.101/2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar”.

Bazuar në Nenin 45 të Ligjit Nr.101/2020, lidhur me formimin kalimtar të organeve drejtuese dhe të administratës zgjedhore, Nenit 183/8 i Kodi Zgjedhor rezulton të ketë përfutur këtë përmbajtje:

“8. Në zgjedhjet e para të përgjithshme dhe në zgjedhjet e para vendore, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, e drejta për propozimin e anëtarëve të KZAZ-ve, KOV-ve dhe të GNV-ve përcaktohet sipas rezultatit të zgjedhjeve të përgjithshme të vitit 2017 dhe konfigurimit shumicë-pakicë të Kuvendit në çeljen e tij, menjëherë pas këtyre zgjedhjeve”.

Neni 48 i Ligjit Nr.101/2020 Dt.23.7.2020, parashikon se:

“Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare”.

Ligji Nr.101/2020 Dt.23.07.2020 rezulton të jetë botuar në Fletoren Zyrtare Nr.143 Dt.04.08.2020 dhe të ketë hyrë në fuqi më datë 19.08.2020.

Lidhur me zbatimin e kësaj dispozite, shumica argumenton se:

“Në këto kushte lind nevoja për të interpretuar dispozitën tranzitore, në funksion të qëllimit që pati ligjvënësi në hartimin e saj. Kështu, rezultati i zgjedhjeve të përgjithshme të vitit 2017, në kohën e miratimit të ligjit, ishte i njohur për të gjithë dhe, qartazi, ligjvënësi ka synuar që ky rezultat të kushtëzojë ngritjen e organeve të administratës për dy proceset zgjedhore (ato të përgjithshme të vitit 2021 dhe ato vendore të vitit 2023), që do të zhvilloheshin në të ardhmen. Në funksion të këtij qëllimi, organizimi i zgjedhjeve të pjesshme në mars 2022, për kryetar bashkie për gjashtë bashki të vendit, nuk ezauron efektin e dispozitës tranzitore, ndaj Kolegji gjen të drejtë ligjin, mbi të cilin KSHZ dhe KAS, kanë zgjidhur çështjen e kompozimit të GNV-ve për zgjedhjet vendore të datës 14.05.2023 (për këtë çështje janë dakordësuar edhe vetë subjektet zgjedhore të përfshira në mosmarrëveshje)”.

Përkundër përfundimit të shumicës vlerësoj se ligjvënësi, nëpërmjet Ligjit Nr.101/2020, nuk rezulton ta ketë kushtëzuar aplikueshmërinë e rezultatit zgjedhor 2017, me faktin që zgjedhjet e para vendore pas datës 19.08.2020, të mos jenë të pjesshme, apo zgjedhjet e para politike pas kësaj date, të mos jenë të parakohshme.

Mënyra e formulimit të Nenit 183.8 të Kodit Zgjedhor, dikton referimin në rezultatin e zgjedhjeve të përgjithshme të vitit 2017, përjashtimisht në të parat zgjedhje, vendore dhe politike, pas datës 19.08.2020.

Në fakt, të parat zgjedhje vendore pas datës 19.08.2020, rezulton të kenë qenë zgjedhjet e pjesshme vendore të datës 6 Mars 2022, organizuar në gjashtë bashki të vendit.

Pikërisht në këto zgjedhje vlerësoj të ketë qenë i detyrueshëm referimi në rezultatin e zgjedhjeve të përgjithshme të vitit 2017, në funksion të identifikimit të subjektit zgjedhor me të drejtë propozimi të anëtarëve të KZAZ-ve, KQV-ve dhe të GNV-ve.

Mbajtja e këtyre zgjedhjeve, pavarësisht nga shtrirja e kufizuar, nuk vlerësoj të kenë humbur për këtë shkak rëndësinë, me pasojë mosmarrjen e tyre në konsideratë si zgjedhje vendore të zhvilluara në Republikën e Shqipërisë.

Përkundrazi, këto zgjedhje rezulton të kenë përligjur vullnetin e zgjedhësve për 6 kryetarë bashkish, duke angazhuar pa asnjë dallim nga zgjedhjet vendore jo të pjesshme, të gjithë aparatit e administratës zgjedhore, nëpërmjet vendimmarrjeve të të cilit rezulton të jetë certifikuar rezultati zgjedhor, duke përligjur ushtrimin e mandatit të të zgjedhurve vendore, deri në zgjedhjet vendore të vitit 2023.

Në funksion të përligjies së argumentave të mësipërme, i referohem Nenit 2 të Kodit Zgjedhor, që parashikon se:

“Në këtë Kod termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

22. “Zgjedhje të pjesshme” janë zgjedhjet që kryhen në një apo më shumë njësi të qeverisjes vendore për kryetarin e bashkisë ose për këshillin bashkiak, kur mbetet vakant posti i kryetarit të bashkisë ose kur shpërndahet para kohe këshilli bashkiak.

23. “Zgjedhje” janë votimet për Kuvendin, për njësitë e qeverisjes vendore dhe referendumet”.

Në kuptim të përmbajtjes së kësaj dispozite, rezulton që ligjvënësi të ketë përcaktuar tre lloje zgjedhjesh/votimesh në Republikën e Shqipërisë:

- Zgjedhjet/votimet për Kuvendin;
- Zgjedhjet/votimet për njësitë e qeverisjes vendore (kryetar bashkie ose këshill bashkiak);
- Referendumet.

Rrjedhimisht, zgjedhjet/votimet e pjesshme nuk rezulton të jenë parashikuar si lloj i katërt votimi në Republikën e Shqipërisë, çka do të përligjte argumentat e vëna në themel të vendimit të shumicës.

Në këtë kontekst, ndryshe nga shumica vlerësoj se, organizimi në mars 2022, i zgjedhjeve/votimeve të pjesshme për kryetar bashkie për gjashtë bashki të vendit, ezauron plotësisht efektin e dispozitës tranzitore, Nenit 83.8 të Kodit Zgjedhor.

Veç sa më sipër, mosmarrja në konsideratë e zgjedhjeve të pjesshme vendore të datës 6 Mars 2022, në rendin kronologjik të zgjedhjeve vendore të mbajtura në Republikën e Shqipërisë, vlerësoj se deformon formulën identifikuese të subjektit zgjedhor me të drejtë propozimi të

anëtarëve të KZAZ-ve, KQV-ve dhe të GNV-ve në zgjedhjet vendore të datës 14 Maj 2023, përsa kohë shmang rezultatit e zgjedhjeve më të fundit të përgjithshme të vitit 2021.

Rrjedhimisht, në vitin 2023, në funksion të identifikimit të subjektit zgjedhor me të drejtë propozimi të anëtarëve të KZAZ-ve, KQV-ve dhe të GNV-ve, sipas shumicës, i zbatueshëm është konfigurimi shumicë-pakicë në Kuvendin e Shqipërisë 7 vite më parë, pavarësisht se konfigurimi i fundit daton në vitin 2021.

Duke mos rënë dakord me këtë qendrim vlerësoj se, në zgjedhjet vendore 2023, Neni 183.3 i Kodit Zgjedhor ka pushuar së qenuri dispozitë tranzitore, për shkak të prodhimit të një palë zgjedhjeve vendore (edhe pse të pjesshme), pas datës së hyrjes në fuqi të përmbajtjes së tij.

Thënë kjo, vërej se, në vend të përjashtimit Nenit 183.8, i zbatueshëm në rastin në shqyrtim është rregulli i përgjithshëm i parashikuar në Nenet 95 dhe 96 të Kodit Zgjedhor.

Në kuptim të përmbajtjes së këtyre dispozitave dhe përjasjes së tyre me rrethanat faktike¹, PDIU rezulton:

- në listën e partive të opozitës parlamentare, konfiguruar nga zgjedhjet e përgjithshme për Kuvendin të vitit 2021 dhe
- me dy mandate të fituara.

Këto rrethana vlerësohen prej meje përcaktuese në funksion të identifikimit të PDIU-së, si subjekt zgjedhor me të drejtë propozimin e anëtarit të katërt të grupeve të numërimit të votave, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023.

Për sa më sipër, ndryshe nga shumica, e konsideroj të gabuar referencën ligjore të KSHZ dhe KAS në zgjidhjen e çështjes së kompozimit të GNV-ve për zgjedhjet vendore të datës 14.05.2023.

GJYQTARE
Blerona HASA

¹ Referuar rezultateve të zgjedhjeve të përgjithshme të vitit 2021, publikuar në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, <https://kqz.gov.al/results/results2021/results2021.htm>, rezulton se:

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Qarku	Subjekti (Partia/Koalicioni)	Sigla	Partia në Koalicion
109.	Nustret	Sulejman	Avdulla	FIER	Partia Demokratike "Aleanca për Ndryshim"	PD- AN	PDIU
125.	Shpëtim	Hysni	Idrizi	TIRANË	Partia Demokratike "Aleanca për Ndryshim"	PD- AN	PDIU